

Raporti perfundimtar

Per

Vleresimin e punes se kryer ne

Ish Sektorin e Menaxhimit Financiar(Drejtoria e Sherbimeve Financiare dhe Buxhetit)

Bashkia Devoll

I. PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Mbeshtetur ne ligjin nr. 114 date: 22/10/2015 ”Per auditimin e brendshem ne sektorin publik”, Manualin e auditit te brendshem te miratuar me urdherin nr.100 Date:25.10.2016 te Ministrit te Financave, planin vjetor te auditit te brendshem nr prot 257 date 27.01.2020 te miratuar nga kryetari i bashkise Devoll, njoftimin per fillimin e angazhimit te auditimit nr 1078 Prot, date 04.05.2020 “Mision auditimi i kombinuar ne ish **Sektorin e Menaxhimit Financiar**”,u krye gjate periudhes 11.05.2020-22.06.2020,per periudhen nga data 01.03.2017-30.04.2020.Auditimi u krye nga specialistet ne zyren e Auditimit te Brendshem Z.Eduard Shaholli dhe Z.Anida Kaso.

Misioni i ketij auditimi eshte vleresimi i frytshmerise te procesit te menaxhimit te riskut, dhenia e sigurise ,eshte synimi per te shtuar vleren dhe per te permiresuar kontrollin.Nga auditimi i kryer ne **Sektorin e Menaxhimit Financiar**, eshte vleresuar ne teresi sistemi ne perputhje me udhezimet dhe metodikat me qellim qe sistemi i menaxhimit financiar dhe te kontrollit te njesise te audituar,te jene transparente dhe ne perputhje me normat e ligjshmerise, rregullshmerise, frytshmerise dhe kursimit.Jane realizuar te gjitha pikat e programit te pergatitura nga specialistet e auditit.

Deri ne fund te vitit 2019 struktura e personelit te finances ka qene e organizuar ne rang sektori te quajtur Sektori i Menaxhimit Financiar.Me urdherin nr 16 date 27.01.2020 “Per miratimin e struktures se administrates se Bashkise Devoll per vitin 2020” organizimi i ri behet ne rang drejtorie dhe quhet Drejtoria e Sherbimeve Financiare dhe Buxhetit me dy sektore brenda te perfshire qe jane:Sektori i Planifikimit te Buxhetit dhe Sektori i Menaxhimit financiar.

Gjate auditimit ne i jemi referuar me termin Sektori i Menaxhimit Financiar jo se do te auditohet vetem ky sektor i Drejtorise por per faktin qe ne momentin e hartimit te planit vjetor dhe strategjik ka qene ne fuqi struktura e vjeter dhe panvaresisht se ka qene Sektor perseri ka ekzistuar edhe specialisti i buxhetit si pozicion qe tani u be sektor me vete.

Qellimi i angazhimit te auditimit eshte vleresimi dhe dhenia e sigurise objektive,te pavarur mbi veprimtarine ne **Sektorin e Menaxhimit Financiar** per te vleresuar efektivitetin dhe eficencen per arritjen e objektiveve te menaxhimit financiar dhe kontrollit te brendshem dhe njekohesisht dhenia e rekomandimeve per permiresimin e sherbimit.

Ne perfundim te auditimit ne ish **Sektorin e Menaxhimit Financiar** jane kostatuar shkelje te akteve ligjore dhe nenligjore qe kane te bejne me raportet e monitorimit te buxhetit,mos planifikimi real i buxhetit,mos dredhja cdo dite e arketimeve,mos hartimi ne afat i pasqyrave financiare,mos shlyerja e detyrimeve te prapambetuara,mos arketimi i detyrimeve te personave te trete ndaj bashkise.

-Ne sistemin e monitorimit te buxhetit u kostatua se per vitet 2017,2018,2019 mungojne raportet periodike e vjetore te monitorimit.Kjo eshte ne kundersizim me piken 254 e 255 te kapitullit raportet e monitorimit te Udhezimit te Ministrise se Financave nr 2 date 06.02.2012 “Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit”ne zbatim te nenit 65 te ligjit organik te buxhetit.Raportet e monitorimit ne mynyre periodike jane detyrim per informimin e herepashershem te Keshillit te Bashkise mbi ecurine e buxhetit vjetor.

-Ne sistemin e planifikimit dhe realizimit te buxhetit u kostatua se per vitet 2017.2018.2019 ka diferenca te dukshme midis planifikimit dhe realizimit te buxhetit ne PBA cka tregon qe hartimi i buxhetit vjetor nuk eshte bazuar ne parashikime sa me reale te te ardhurave dhe shpenzimeve faktike te viteve te mepareshme.

-Ne sistemin e arketimeve u kostatua qe derdhja e arketimeve nuk behej cdo dite dhe libri i arkes nuk firmosej nga llogaritari(punonjesi qe meret me kontabilizimin e dokumentave te arkes).

-Ne sistemin e hartimit te pasqyrave financiare u kostatua se pasqyrat financiare nuk jane hartuar dhe jane depozituar prane deges se thesarit Devoll duke respektuar afatin ligjor te percaktuar.

-Ne sistemin e detyrimeve te prapambetura u kostatua se nuk ka nje plan per minimizimin dhe likuidimin e detyrimeve te prapambetura.

-Ne sistemin e arketimit te detyrimeve qe kane te tretet ndaj bashkise u kostatua se ka nje shume te konsiderueshme te pa levizur qe prej vitit 2018 dhe qe nuk jane mare masa per tu arketuar nga ana e bashkise.

VI. Rekomandimet

Ne perfundim te procesit te vleresimeve te bera nga specialistet e auditimit per personat pergjegjes bazuar ne nenin 6 pika c e Ligjit nr 114/2015 date 22.10.2015 “Per auditimin e brendshem ne sektorin publik” per arrijten e objektiveve te Drejtorise se Sherbimeve Financiare dhe Buxhetit si dhe per te ritur efektivitetin ne punen funksionimin dhe drejtimin e kesaj drejtorie,**rekomandojme:**

1.Gjetje nga auditimi.

Per vitet 2017.2018,2019 mungojne raportet periodike e vjetore te monitorimit.Kjo eshte ne kundërshtim me piken 254 e 255 te kapitullit raportet e monitorimit te Udhezimit te Ministrise se Financave nr 2 date 06.02.2012 “Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit”ne zbatim te nenit 65 te ligjit organik te buxhetit.

Raportet e monitorimit ne mynyre periodike jane detyrim per informimin e herepashershem te Keshillit te Bashkise mbi ecurine e buxhetit vjetor.Ato duhet te paraqesin performancen e arritur nga kjo njesi vendore ne termat e produkteve,angazhimi per te mare veprimet e duhura korigjuese per te permiresuar situaten aty ku eshte e nevojshme te nderhyet.Gjithashtu sherben per ritjen e trasparences,pergjegjshmerise ne perdorimin e fondeve publike si dhe ne permiresimin e planifikimit dhe ekzekutimit te buxhetit te vitit korent ne aritjen e objektive.

1.1Rekomandimi.

Te informohet periodikisht Keshilli i Bashkise me raportet e monitorimit dhe realizimit te buxhetit te cilat do te sherbejne per ritjen e trasparences,pergjegjshmerise ne perdorimin e fondeve publike si dhe per permiresimin e planifikimit dhe ekzekutimit te buxhetit te vitit korent ne aritjen e objektive.

Personi pergjegjese:Pergjegjesi i Sektorit teBuxhetit

Afati:Ne vazhdim

2.Gjetje nga auditimi

Per vitet 2017.2018.2019 u kostatua se ka diferenca te dukshme midis planifikimit dhe realizimit te buxhetit ne PBA cka tregon qe hartimi i buxhetit vjetor nuk eshte bazuar ne parashikime realiste te te ardhurave dhe shpenzimeve faktike te viteve te mepareshme.

2.2 Rekomandimi

Te behet planifikim me i sakte i buxhetit per shpenzimet operative dhe monitorimi i realizimit te tyre.Pergjegjesi i Sektorit teBuxhetit ne vazhdim te mare masa per hartimine nje buxheti real mbeshetur ne realizimin e mundshem e objektive dhe te ardhurave.

Personat pergjegjese:Pergjegjesi i Sektorit te Buxhetit

Afati:Ne vazhdim

3.3 Gjetje nga auditimi

Gjate auditimit te arkes u kostatua qe derdhja e arketimeve nuk behej cdo dite dhe libri i arkes nuk firmosej nga llogaritari(punonjesi qe meret me kontabilizimin e dokumentave te arkes).

3.3 Rekomandimi

Te behet derdhja e arketimeve cdo dite , libri i arkes te firmoset nga llogaritari(punonjesi qe meret me kontabilizimin e dokumentave te arkes),te behet akt rakordimi cdo muaj.

Personat pergjegjes. Arketari,Specialistja e kontabilitetit

Afati:Menjehere

4.Gjetje nga auditimi

Pasqyrat financiare nuk jane hartuar dhe jane depozituar prane deges se thesarit Devoll duke respektuar afatin ligjor te percaktuar .Pengesa kryesore per paqyrat e vitit 2019 sipas hartueses se tyre ka qene mungesa e inventareve.

4.4 Rekomandimi

Pasqyrat financiare te hartohen dhe depozitohen prane deges se thesarit Devoll brenda afateve ligjore duke bashkepunuar ngushte me komisionin e inventarizimit ne rastet kur inventarizimi behet pengese per hartimin e tyre dhe te vihete ne dijeni menaxhimi i larte menjehere kur ka pengesa te tilla.

Personat pergjegjes. Pegjegjesi i Sektorit te Menaxhimit Financiar

Afati:Ne vazhdim

5.Gjetje nga auditimi

Shuma totale e detyrimeve sipas informacionit te dhene nga punonjesis e ish Sektorit te Menaxhimit Financiar eshte 350,097,981 mije leke.

Shuma 15,271,047 mije leke e tabelës së dytë janë detyrime për disa vendime gjyqësore.

Problem mbetet që këto detyrime akoma nuk janë ekzekutuar dhe akoma nuk ka një plan të detajuar për likuidimin e detyrimeve sic është rënë dakord edhe në auditimin e detyrimeve të prapambetura të kryer nga auditimi i brendshëm.

5.5 Rekomandimi

Te likudohen ne vazhdimesi detyrimet e prapambetura sipas nje radhe kronologjike duke zvogeluar shumen totale te detyrimeve dhe kur eshte e mundur te mos trashegohen fatura te pa likuduara nga viti paraardhes.

Personat pergjegjes. Pegjegjesi i Sektorit te Menaxhimit Financiar

Afati:Ne vazhdim

6.Gjetje nga auditimi

Gjate analizimit te pasqyrave financiare per vitin 2019 bie ne sy qe ne pasqyren e pozicionit financiar ne llogarine nr 468 “Debitore te ndryshem” kemi nje mbyllje te vitit ushtrimor ne shumen 66,634,236 mije leke . Edhe viti paraardhes eshte mbyllyr me po kete shifer.

Sipas pasqyrave financiare gjate vitit 2019 nuk eshte bere asgje per zvogelimin e shumes te kesaj llogarie.Shuma ka ngelur e njejte edhe per vitin 2018 edhe per vitin 2019.

Kjo llogari e thene ndryshe jane te ardhura per tu mare(per tu mbledhur) qe vijne nga detyrime te ndryshme sic mund te jene taksa te papaguara,gjoha te ndryshme etj.

6.6 Rekomandimi

Sektorit i Menaxhimit Financiar ne Drejtorine e Sherbimeve Financiare dhe Buxhetit eshte pergjegjese dhe duhet te mare masa per arketimin e ketyre shumave qe individe te ndryshem kane kundrejt Bashkise Devoll duke bashkepunuar aty ku eshte e nevojshme edhe me Sektorin Juridik per zgjidhjen e ketij problemi.

Personat pergjegjes. Pegjegjesi i Sektorit te Menaxhimit Financiar,

Pergjegjesi i Sektorit Juridik

Afati:Menjehere.

Specialistet e Auditit te Brendshem